
OPERATORI I BLERJEVE TË PËRQËNDRUARA SH.A

Data:04/09/2026

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Mallra

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

Objekti i procedurës: “Blerje Materiale Dentare Dhe Laboratorike” për nevoja të Klinikës Stomatologjike Universitare Tiranë

Kodi përkatës në fjalorin e përbashkët të prokurimit (FPP):

Materiale Konsumi Dentare 33141800-8

Vlera e fondit limit: 15,000,000 (pesëmbëdhjetë milionë) lekë pa TVSH ose 162,831.09 (njëqind e gjashtëdhjetë e dy mijë e tetëqind e tridhjetë e një euro e nëntë cent) EURO pa tvsh.

*Vlera e mësipërme është konvertuar në monedhën Euro sipas kursit zyrtar të Bankës së Shqipërisë, datë 04.09.2026, me kurs këmbimi 92.12 (nëntëdhjetë e dy pikë dymbëdhjetë) lekë.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” (të ndryshuar) nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), Autoriteti/Enti Kontraktor, Operatori i Blerjeve të Perqendruara në rolin e Organit Qëndror Blerës, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas **Shtojcës 9;**

b. Sigurimin e Ofertës, sipas **Shtojcës 4;**

Argumentimi: Kriteret e mesiperme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertës”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për

Prokurimin Publik” i ndryshuar si dhe ne mbeshtetje te nenit 26, nenit 30, pika 1, te VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik: citojme Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82, i LPP “1. Bashke me dorezimin e kerkesave per pjesemarrje ose te ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojne si prove paraprake ne vend te disa vertetimeve te leshuara nga autoritetet publike ose pale te treta, formularin permblendes te vetdeklarimit, sipas parashikimeve te ketij ligji. Permbajtja e ketij formulari percaktohet ne rregullat e prokurimit publik”.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kriteret duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 9.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 76 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 25 të VKM-se Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën, duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2023, 2024, 2025), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se vlera e fondit limit objekt prokurimi**. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është në nenin 77 “Kërkesat për kualifikim”, pika 3 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar, në të cilin gjejmë të përcaktuar se: 3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës”, nenin 43 “Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare” pika 2/a dhe nenin 47 “Procedura e hapur” të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 2 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të

ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se: “Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata”. Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë ekonomike dhe financiare të operatorëve ekonomik ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitet ekonomike dhe financiare për të përmbushur kontratën sic është parashikuar nga Autoriteti Kontraktor.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vlera e kërkuar jo më e vogël se vlera e fondit limit të kontratës që prokurohet është në përputhje me përcaktimet në nenin 43 “Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare” pika 2/a të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, ku përcaktohet se:

Pika 2. “Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohe operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: a) dyfishin e vlerës së përllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar”. Në rastin konkret nga ana e Njesisë së Prokurimit është konsideruar e arsyeshme që vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit me qëllim nxitjen e pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik, nxitjen e konkurrencës ndërmjet operatorëve ekonomikë si edhe të sigurimin e një trajtimi të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë ofertuesit e mundshëm ekonomikë. Duke patur parasysh, përcaktimin e bërë në nenin 43 “Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare” pika 2/a, AK nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së përllogaritur të vlerës së lotit në kërkesën për kualifikim, por në respektim të parimeve ligjore dhe në përmbushjen e qëllimeve të ligjit të prokurimit si më sipër cituar ka tagrin të kërkojë një vlerë më të ulët se dyfishi i vlerës së përllogaritur të kontratës për përmbushjen e vlerës së xhiros minimale vjetore. Kjo vlerë është kërkuar duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj, që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorit ekonomik, të cilët duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të çertifikuara të balanceve të viteve: (2023, 2024, 2025) të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese. Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse në dy balance të njëpasnjëshme nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar; nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar ku përcaktohet se: “Nëse vlerësohet, autoriteti/enti kontraktor mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivit. Nëse kërkohen një ose dy balance, kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në bilancin/et e kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit”, si dhe në pikën 5 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të

ndryshuar ku përcaktohet se: “*Tatimpaguesit që mbajnë kontabilitet sipas kërkesave të ligjit përkatës, paraqesin deklaratën vjetore së bashku me pasqyrat financiare, si dhe të dhëna të tjera të përcaktuara në udhëzimin e ministrit përgjegjës për financat për zbatimin e këtij ligji.*”, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “*Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare*” të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri, për paraqitjen e bilnaceve, është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj, që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorit ekonomik, të cilët duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

1.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën **jo më pak se 39% e vlerës së fondit limit**. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

- a) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara
- b) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “*Për prokurimin publik*” të ndryshuar nenit 40 pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik*”, të ndryshuar ku përcaktohet se: “*Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.*”

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40% të vlerës së fondit limit. Përqindja e kërkuar është konsideruar e nevojshme për të provuar besueshmërinë dhe përvojën e operatorëve ekonomik ofertues, si dhe aftësinë e tyre në ofrimin e mallrave të ngjashëm me objektin e prokurimit për realizimin me sukses të kontratës

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë **Autorizim për tregtim të pajisjeve mjekësore**, të lëshuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, sipas ligjit 89/2014 “Për pajisjet mjekësore” i ndryshuar.

Argumentimi: Në pikën 1 të nenit 77 të LPP përcaktohet se: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.” dhe në pikën 4 të tij përcaktohet se: “4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”

Bazuar në nenin 40 pika 5/a përcaktohet se: “Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: a) licencat profesionale për prodhimin dhe ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore;”

Ky kriter vendoset dhe në zbatim të Ligjit nr. 89/2014 "Për pajisjet mjekësore," i ndryshuar, ku në nenin 4 pika 1 dhe 3 të tij përcaktohet se: “Në këtë ligj termit e mëposhtëm kanë këto kuptime: 1. “Pajisje mjekësore” është çdo instrument, aparat, material ose mjet tjetër, i përdorshëm vetëm ose i kombinuar dhe që veprimin e synuar në ose mbi trupin e njeriut e kryen i ndihmuar nga mjete farmakologjike, imunologjike apo metabolike: a) për diagnostikimin, parandalimin, monitorimin, trajtimin ose zbutjen e sëmundjes; b) për diagnostikimin, monitorimin, trajtimin, zbutjen ose kompensimin e një dëmtimi apo të metes; c) për hetimin, zëvendësimin ose modifikimin e anatomisë apo të një procesi fiziologjik; ç) për kontrollin e ngjizjes; d) produkte të dedikuara posaçërisht për pastrimin, dezinfektimin ose sterilizimin e pajisjeve; dh) pajisjet të cilat nuk janë të destinuara për një qëllim të caktuar mjekësor si më poshtë: i) produkte të destinuara për t’u futur plotësisht ose pjesërisht në trupin e njeriut përmes mjeteve invazive kirurgjikale, me qëllim të modifikimit të anatomisë ose fiksimit të pjesëve të trupit, me përjashtim të produkteve për tatuazhe dhe piercing; ii) substancat, kombinime të substancave, ose produkte të destinuara për t’u përdorur për mbushjen e mukozës së fytyrës ose zona të tjera të lëkurës ose mukozës me anë të injeksionit subkutan, submukozë ose intradermal, duke përjashtuar ato për tatuazhe; iii) pajisjet e destinuara për t’u përdorur për të zvogëluar, hequr ose shkatërruar indin dhjamor, siç janë pajisjet për liposuction, lipolizë ose lipoplastikë; iv) rrezatimi elektromagnetik me intensitet të lartë, të tilla si: pajisje që lëshojnë rrezatim infra të 2 kuq, dritë të dukshme dhe ultra vjollcë, të destinuar për përdorim në trupin e njeriut, duke përfshirë burime koherente dhe jokohërente, spektër monokromatik dhe të gjerë, si lazer dhe pajisje të lehta me puls intens, për rishfaqjen e lëkurës,

tatuazhi ose heqja e flokëve ose trajtim tjetër i lëkurës; v) pajisjet e destinuara për stimulimin e trurit që aplikojnë rryma elektrike ose fusha magnetike ose elektromagnetike që depërtojnë në kranium për të modifikuar aktivitetin neuronal në tru. 2. “Aksesori” është mjeti, i cili, megjithëse nuk klasifikohet si pajisje mjekësore, është destinuar specifikisht nga prodhuesi i tij për t’u përdorur së bashku me një pajisje mjekësore, duke mundësuar që pajisja mjekësore të përdoret në përputhje me përdorimin e saj të synuar. 3. “Pajisje mjekësore e diagnostikimit in vitro” është një reagent, produkt reagenti, produkt kalibrator, material kontrolli, kit, instrument, aparat, pajisje apo sistem, që përdoret vetëm ose në kombinim, i destinuar nga prodhuesi për t’u përdorur in vitro për ekzaminimin e mostrave, përfshirë gjakun dhe indet, që rrjedhin nga trupi i njeriut, me qëllim sigurimin e informacionit: a) lidhur me një gjendje fiziologjike ose patologjike; b) lidhur me një anomali kongjenitale; c) për të përcaktuar sigurinë dhe përshtatshmërinë me një pranues potencial; ç) për të monitoruar masat terapeutike.....” dhe nenit 22 të ligjit ku përcaktohet se: “1. Tregtimi me shumicë i pajisjeve mjekësore kryhet nga tregtuesit me shumicë, të cilët janë persona juridikë të licencuar për këtë veprimtari, sipas legjislacionit në fuqi për licencat, autorizimet dhe lejet. Kushtet e licencimit, dokumentet shoqëruese, afatet e vlefshmërisë dhe procedurat e shqyrtimit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave. Ministri përgjegjës për shëndetësinë është organi që shqyrton dhe merr vendimin përfundimtar për kërkesat për pajisjen me licencë për tregtimin me shumicë të pajisjeve mjekësore. Ministri përgjegjës për shëndetësinë është autoriteti përgjegjës për revokimin dhe pezullimin e kësaj licence. 2. Tregtuesi me shumicë i pajisjeve mjekësore kryen importin dhe eksportin e pajisjeve mjekësore. 3. Ministria përgjegjëse për shëndetësinë i dërgon Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave listën e tregtarëve me shumicë dhe, rast pas rasti, e njofton këtë drejtori për ndryshime apo shtesa të mundshme në këtë listë”. Referuar këtyre dispozitave mallrat objekt prokurimi të kërkuara konsiderohen si pajisje mjekësore, për të cilat ligji parashikon që treguesit e këtyre mallrave duhet të pajisjen me autorizim nga strukturat përgjegjëse.

Kërkesa përse i përket këtij autorizimi synon të sigurojë një nivel të lartë mbrojtjeje të sigurisë dhe shëndetit për pacientët, përdoruesit dhe palët e treta. Për autorizimin e tregtimit të pajisjeve mjekësore, kriteret e kualifikimit përfshijnë përputhjen me standardet e sigurisë dhe efektshmërisë të përcaktuara nga prodhuesi, si dhe respektimin e procedurave të regjistrimit dhe vlerësimit të konformitetit.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë **certifikatë konformiteti CE** (ose deklaratë konformiteti DC), ose **certifikimin FDA** për të gjithë artikujt e ofruar, sipas kategorizimit të tyre.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 “Kërkesat për kualifikim” pika 4, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar ku shprehimisht citohet: “4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie” si dhe pika 8 e nenit 40 “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave” të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të realizojnë objektin e prokurimit në përputhje me kërkesat e specifikimeve teknike, duke furnizuar mallra cilësorë dhe pa dëmtime estetike apo në strukturë, deri në ambientet e Autoritetit Kontraktor përfitues. Certifikatat e konformitetit CE (ose deklarata e konformitetit DC nëse është rasti) ose FDA

approval janë dokumente të rëndësishme që vërtetojnë përputhjen e produkteve me standardet e sigurisë dhe cilësisë. Theksohet se mallrat objekt prokurimi kanë si destinacion final Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, është e domosdoshme që furnizimet të jenë cilësore dhe konform rregullave të parashikuara nga aktet e BE (për konformitetin CE) ose të Shteteve të Bashkuara (Për aprovimin FDA). Ligjvënësit respektivë të këtyre rajoneve kanë parashikuar se materialet objekt prokurimi (sipas klasifikimit të riskut që kanë), t'i nënshtrohen një vlerësimi konformiteti rigoroz, nga palë të treta (OVK – organizma të vlerësimit të konformitetit), të akredituara, me qëllim që të përmbushin kriteret e cilësisë.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë **katalog/skedë teknike** për artikujt objekt prokurimi, ku të përfshihen edhe specifikimet teknike të hollësishme, në mënyrë që të provohet pajtueshmëria me specifikimet teknike sipas dokumenteve të tenderit.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në përputhje me nenin 77 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe pikën 6/b, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar. Kërkesa për paraqitjen e katalogëve/skedës teknike nga prodhuesi është një kërkesë e domosdoshme pasi i jep mundësinë Autoritetit kontraktor si Organ Qendror Blerës verifikimin e përputhshmërisë së specifikimeve teknike të artikujve të ofertuar nga operatorët ekonomikë me specifikimet teknike të kërkuara.

Kërkesa për katalogun /skedën teknike ka disa avantazhe: Besueshmëria e informacionit: Një dokument teknik garanton që informacioni të jetë i saktë dhe i përditësuar. Përputhshmërinë me specifikimet teknike e cila siguron që produktet e ofruara përputhen me specifikimet teknike të kërkuara në dokumentet e prokurimit. Parandalimi i mashtrimeve: Redukton rrezikun e mashtrimeve ose të ofrimit të produkteve të falsifikuara.

Për sa më sipër, përmes përmbushjes së kësaj kërkesë, AK krijon siguri dhe garanci se mallrat me të cilët do të furnizohet janë sipas specifikimeve të përcaktuara në DST. Ky katalog do të shërbejë gjithashtu edhe në procesin e marrjes në dorëzim të mallrave objekt prokurimi nga Autoriteti Kontraktor përfitues për të kryer krahasueshmërinë e specifikimeve teknike gjatë marrjes në dorëzim të tij.

2.3.4 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë certifikimin **ISO 9001:2015** mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë” ose **ekuivalent** në përputhje me objektin e prokurimit, lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose nga organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Çertifikata duhet të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

Argumentimi: Ky kriter është përcaktuar bazuar në nenin 79, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar dhe nenin 44, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar.

2.3.5 Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqesë **një deklaratë**, me anë të së cilës merr përsipër të kryejë shërbimin e transportit të mallit objekt prokurimi në adresën e përcaktuar nga autoriteti kontraktor përfitues konform specifikimeve teknike.

Argumentimi. Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 40, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët të sigurojnë autoritetin kontraktor se transporti i mallit do të realizohet në kohë dhe në vendndodhjen përkatëse të caktuar nga Autoriteti Kontraktor përfitues.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Argumentimi i specifikimeve teknike :

Nr.	Artikulli	Njesia	sasia
1	Acid kompoziti	Shiringe x 5ml	12

2	Angel mikromotori	Cope	10
3	Aerotor/ 9 dalje/ fiber optike	Cope	10
4	Bond universal	Flakon x 5ml	18
5	Instr per perpunim kanali K/H file 15/0.2	Pllaket x 6 cope	40
6	Instr per perpunim kanali K/H file 20/0.2	Pllaket x 6 cope	40
7	Instr per perpunim kanali K/H file 25/0.2	Pllaket x 6 cope	40
8	Instr per perpunim kanali K/H file 15-40/0.2	Pllaket x 6 cope	40
9	Instr per perpunim kanali K/H file nr.8 nr.10/0.2	Pllaket x 6 cope	40
10	Instr per perpunim kanali seri e madhe(45-80)	Pllaket x 6 cope	40
11	Betadin 10%	Flakon 100ml	20
12	Instrument per endomotor seri	Kuti x 5 cope	40
13	Paste per pastrim dhe lustrim gurzash	Kuti x 100gr	15
14	Doreza njeperdorimshe Kirurgjkale sterile	kutix50pale	1000
15	Disqe abraziv plus mandrene	Kuti x 120 cope	25
16	Endofiller premixed	Shiringe x 1gr	16
17	Material pluhur per mbushje te perhershme kanali/ Endometasone	Flakon x 14gr	15
18	Eugenol i paster	Flakon x 30ml	15
19	Freze/ang.mikrm.celik.nr.2-8(rond)	Pllakete x 5	150
20	Freze/angel turb.diamant rond nr 12-18c	Pllakete x 5	20
21	Freze/angel turb.diamant fissure nr.0,12/0,14/0,16	Pllakete x 5	20
22	Freze/angel turb.diamant flake nr.0,14/0,18	Pllakete x 5	20
23	Freze/angel turb.diamant modelimi	Pllakete x 5	25
24	Furce teli per past.e instr. me bisht druri	Cope	25
25	Furce pastrim gurzash	Cope	150
26	Fill retraktar	nr.(000),(00),(0)	15
27	Gome llustre kompoziti e bardhe/gri	Kuti x 100	15
28	Gota plastike	Qese x 100	50
29	Hidroksid kalciumi per mbushje kanalesh pa jodoforme	Shiringe x 3 gr	10
30	Hidroksid kalciumi per grade te IV	Shiringe x 3gr	30
31	Hidroksid kalciumi/Shtr.izoluese,baze+kataliz.	Kuti(tb.13gr x 11gr)	15
32	Hidroksid kalciumi/Shtr.izoluese me llampe	Tubet 2 gr	20
33	Hipoklorit Na 5%	Flakon x 500ml	30
34	Material per mbushje provizore(kavidur)	Flakon x 40gr	30
35	Guttaperca madhesi te ndryshe nr.(15-30)	Kuti x 120 fije	40
36	Guttaperca nr.25/0,2	Kuti x 120 fije	40
37	Guttaperca seri e madhe(45-80)	Kuti x 120 fije	5
38	Kanjula aspiratori	Qese x 100	40

39	Kit Kompoziti(8 tub.x4gr+acid 5ml +bond universal)	Kuti	15
40	Kit Kompoziti flow(4tubx2gr)bond 5ml,acid 5ml	Kit	20
41	Kunja interdental druri	Kuti x 100 fije	20
42	Matrica celiku.model/kompozit.molar	Qese x 10cope	25
43	Matrica celiku.model/kompozit.premolar	Qese x 10cope	25
44	Mbulesa tavoline/ Mantelina	Kuti x 500 cope	50
45	Mbulesa unitesh	kutix10cope	50
46	Paste devitalizimi / Devitec	Flakon x 6 gr	20
47	Pambuk	Pako x 100gr	40
48	Role pambuku	Pako x 15cope	10
49	Portmatrice rrethore(njeperdorimshe) molare	Cope	250
50	Portmatrice rrethore(njeperdorimshe) premolare	Cope	250
51	Strips celuloidi	Kuti x 100 fije	15
52	Solucion fiziologjik	Flakon x 500 ml	60
53	Syze plastike mjeku	Cope	10
54	Strips abraziv per mb.kompozit	Pako x 100fije	15
55	Solucion per dezinfektimin e angelave	Flakon x 1L	100
56	Solucion per shkrirjen e guttaperches / Eucaliptol	Flakon x 10ml	20
57	Solucion parasterilizimit te instr.	Flakon x 1L	40
58	Solucion hemostatik	Flakon	15
59	Skafander per fytyre (mjeku)	Cope	20
60	Cement glassionomer per shtrese izolimi	Shiringe x 2 gr	40
61	Cement rezinoz autopolimerizues	Flakon x 8gr	5
62	Vida kanali inox rikostr/kulti 120cope+2 celsa	Set	5
63	Vida qelqi	Cope	50
64	Anestetik topical gel	Tubet	20
65	MTA	Shiringe	20
66	Zgjerues kimik kanalesh (EDTA)	Shiringe	20
67	Absorbent per kanale nr.25,30,35, 40	Kuti x 200fije	25
68	Absorbent seri e madhe(45,50,55,60,70)	Kuti 200 fije	10
69	Tableta per shplarje goje	Kuti x 250	5
70	Bacinel per vegla josterile	Cope	10
71	Fluar kompoziti	Set x 6 cope	25
72	Kloretil spray	Flakon	30
73	Vizore endo	Cope	10
74	Furce bondi	Kuti x 100 cope	1
75	Llampe polimerizimi portable	Cope	5
76	Glassionomer kapsule	Kuti x 20 cope	10
77	Fluor xhel	Flakon x 500ml	10

78	Silante	Shiringe	30
79	Silver Fluor Diamina (SDF)	Flakon	10
80	Gel ndihmes ne sherimin, qetesimin dhe mbrojtjen e mukozes se gojes nga demtimet, infeksionet, gingivitis dhe ulçerat.	Tub x 20ml	20
81	Gel ndihmes ne rigjenerimin e mukozes orale	Tub x 15 ml	25
82	Gel për parandalimin dhe mjekimin e infeksioneve mikolitike të gojës e faringut polisorbate etj.	Tub x 40 gr	15
83	Kavitron	Cope	10
84	Oksigjene (uje i oksigjenuar)	Flakon x 250 ml	50
85	Set pasqyrash për foto intraorale/okluzale te medha/bukale laterale/frontale/doreze inoksi per te mbajtur pasqyren	set x 4 cope	20
86	Mbajtëse paste detartrazhi	Cope	50
87	Varnish Fluori Monodoze	Cope	250
Kirurgji &Ortopedi			
88	Anestetik topikal spray	cope	50
89	Anestezi me adrenaline articaine hcl4%	pako x 50ampula	150
90	Anestezi pa adrenaline mepivacaine 3%	pako x 50 ampula	10
91	Anestezi tropikal ,xylocaine 10% ce spraj	flakon x 50	10
92	angel turbine,Titan,320000-400000 xhiro 4 dalje	cope	10
	Angel turbine (fiber optike /2dalje)	cope	16
93	Celes kavitrioni	cope	3
94	Cement /35gpluhur 15ml likid+dozator per pluhurin e cementit +bllok perzierje +spatula plastieke perzierje	cope	12
95	Cement I perkohshem me perberje hidroksid kalciumi/tubeta50gr+spatul perzierse plastike,bllok perzierje	set	12
96	Contragel anello rosso 1/5 shpejtesia 200.000 xhirro trupi titan,kuzhinieta ,qeramike 4 brima per hedhje uji	cope	12
97	Dezifektant per instrumenta dentare ,si pasqyre presele,sonde ,etj dhe ato te imta para sterilizimit	flakon x 1000ml	100
98	Disk per pjesamen	cope	15

99	Dyll kockor per ndalimin e hemoragjise x 2.5gr	cope	15
100	Dyll universal me fleta x 20	kuti x 500gr	150
101	Elevator I kthyer djathtas ce stainless steel	cope	15
102	Elevator I kthyer majtas ce stainless steel	cope	15
103	Elevator mukoperiostal PRICHARD CE	cope	9
104	Elevator te drejte te gjere ce stainless steel	cope	15
105	Elevator te drejte te holle ce stainless steel	cope	15
106	Fluar per fillin retraktues	cope	10
107	Freza karbiti per prerje koronash,ure.porcelan	pllaketx 5	12
108	Freza kockore per turbine	cope	150
109	Freza per pjesament fisure (karbid),CE	cope	150
110	Freza rezine ,madhesi te ndryshme per pjesamen	cope	30
111	Freza te gjata pjesament rond ,kabit,CE	cope	150
112	Furca teli pastrim instrumentash me bisht druri cope		9
113	Garza thithese te gatshme ne kirurgji	kuti x 50	300
114	Glasiomer cement per shtrese izolimi	shiring x 2gr	6
115	Gome ilustrimi per pjesamen , madhesi te ndryshme	cope	30
116	Gure te kuq per pjesamenashpersi e mesme	cope	30
117	Hapse goje kirurgjikale stainless steel	cope	30
118	Kaliber mates	cope	2
119	Kanjula transparente me koke te shkeputeshme	qese x 100	40
120	Kapese perparese	cope	60
121	Kit daresh kirurgjikale (14 dare) CE	KIT X 14	3
122	Kit ekzaminimi (sonde ,pasqyre ,presele)	cope	20
123	Klema kirurgjikale CE	cope	9
124	Kocke humane ,allograft,partikula kockore 2cc	gram	6
125	Kontragel implantar 20:1diameter 2,35 trup titan me rezistencenga gervishjet max torq 80 N	cope	6
126	Kunja interdentalare druri 1,181	kuti x 100 fije	50
127	Lama nr 3 12	kuti 100	6
128	Lama nr 3 15,	kutix100	20
129	Leter artikulacioni forme drejtekesdeshe te drejte	set x 12 blloqe	30
130	Luge per [acient pa dhembe nr 1,2,3	setx2	90

131	Luge per pacient me dhembe	set x 2	80
132	Luge per pacient pjeserisht me dhembe	setx2	25
133	Maja per flakonat e vajit te tubines	cope	30
134	Maska fytyre,ce blu per lekure sensitive e bere nga cellulosa hypo alergjike	pako x 50	100
135	Maska mbrojtese me flete transparente per kirurgj(per skafander)	kit x 10 fleta	15
136	Material pluhur per mbushje te perhereshme kanali	flakon x14gr	4
137	Membran kockore ,qeliza mezekimale heterologe 0,5mm mr rezorbim reth 4 muaj 30x30mm	cope	9
138	Negativoskop	cope	2
139	Paste termoplastike /rregullimi I lugeve individuale 140 ml ,activator 60ml)	kuti x 10 shkopinj	40
140	Perperese pacienti e tavoline me 2 shtresa	kuti x 500	100
141	Pistolet per aplikim silikoni te imet	cope	2
142	Pjesament kirurgjikal I drejte 1/1 diameter 2,35mm me irrigim te jashtem qe leshohet me tubin e fiziologjikut	Cope	9
143	Set frezash turbine perparimi	kuti x 10	15
144	Set kirurgjikal operacion 3 perparese mjeku 3 kapuca ,3 mbulesa tavoline ,3 pale doreza kirurgjikale,3 maska ,qese per tubat e aspirimit.	set	100
145	Shiringa veteaspiruese c me hapje anesore	cope	15
146	Solucion pastrimi lugesh nga materiali mases	lit	30
147	Spatula cementi	cope	30
148	Spatula modelimi per dyll me madhesi mesatare	cope	50
149	Sutura pga absorbabel 3.0 4.0 5.0 3/8 19 mm	kuti x 12	80
150	Uje distiluar ,steril	bidonx4 litra	40
151	Xhel Hemostatik	flakon x 30ml	3
	Laboratori		
152	Alkol	lit	123
153	Allci e forte	thes 25 kg	6
153	Alginat	qese x 453gr	200
154	Baze alumini me silikon rezistent per derdhjen e masave te allcise	cope	4
155	Dentrine Vita VM13 A1 ose ekuivalent	kuti50gr	6
156	Dentrine Vita VM13 A2 ose ekuivalent	kutix50gr	6

157	Dentrine Vita VM13A3 ose ekuivalent	kutix50gr	6
158	Dentrine Vita VM13A4 ose ekuivalent	kutix50gr	6
159	Dhembe rezine me forma dhe ngjyra sipas kërkeses se laboranteve	set	540
160	Disqe metali +mandrene	cope	10
161	Dizifektant masash	bidon x 5 l	15
162	Dyll I kuq	kuti	112
163	Dyll kanalesh3,5/2,5mm	kuti	2
164	Freza rezine per laborator	cope	45
165	Furce e zeze e madhe	cope	27
166	Furce me qime te zeza	cope	5
167	Furce pambuku	cope	42
168	Glazure Vita +Likid Glazure ose ekuivalent	set	3
169	Gure roze motorri	cope	9
170	Incizal END	kutix50	5
171	Incizal ENL	kuti x50gr	6
172	Instrumenta per pasrimin e dhembeve	set x 4 cope	5
173	Intermedie Dylli per urat super /infer	qese x 10	4
174	Izolant allci -Resine	shishe 500ml	31
175	Izolant per kapucat e dyllit	flakon x 50	2
176	Izolant protezash	flakon x1liter	38
177	Izolant specifik sprai per izolimin e silikonit	200ml	4
178	Konfeter	cope	47
179	Leter abseseti 25 meter 55 mm	kuti	2
180	Likid Monamer per rezine akrilike per protezat e levishme	shishe 500ml	62
181	Likid monameri I ngrohte per rezine delikate per protezat e levizshme	shishe 500ml	96
182	Likid ngjites per forcimin e ngjitjes se dhembeve akrilike	shishe 30ml	3
183	Likid opakeri Vita VM13 ose ekuivalent	flakonx50ml	5
184	Likid per dentin dhe enamel Monmase	shishe x50ml	3
185	Metal urash	kuti 1 kg	5
186	Mufle per protezat totale	cope	36
187	Opaker Vita VM13A1 ose ekuivalent	kutix50gr	6
188	Opaker Vita VM13A2 ose ekuivalent	kutix50gr	6
189	Opaker Vita VM13A3 ose ekuivalent	kuti x 50gr	6
190	Opaker Vita VM13A4 ose ekuivalent	kuti x50gr	6
191	Paste ilustrimi	tubet x200	35

192	Pinceta per kapje dhembëve nga shperlarsi	cope	17
193	Ponice	kg	54
194	Porcelan me imitim gingive	kuti x25gr	2
195	Profit baze	kuti	31
196	Rere Sabloze 50mikron	kovex5kg	3
197	Rezine e ftohte akrilike per protezat e levizshme ,ngjyra klasike roze	1000gr pluhur+ 1000ml likid	25
198	Rezine e ngrohte per protezat e levizshme ,ngjyra klasike roze	1000gr pluhur+ 1000ml likid	1
199	Ritardante per silikone Orange plus	flakon10ml	2
200	Rivestiment urash +likid	set 160gr pluhur+1000ml likid	10
201	Rrezine arthocryl transparente(per orto)	Set 1000 gr pluhur 500 ml likid	3
202	Rrezine e ftohte	set 500 gr pluhur 250 gr likid	2
203	Set manikyr hollues per kultet	set	2
204	Sharra allcie	cope	30
205	Silikon laborator 5kg A +5kgb	kove x 5 kg	8
206	Silikon precizioni potokalli 300mlA+B	set 300ml+aktivato r 300ml	5
207	Silikon kondesimi	set (Puty 910ml,Light body,140ml Activator 60ml	30
208	Silikon Adicioni Super lightbody me pistolette	2x50ml+ 12 maja perzierse	30
209	Spatula modelimi per dylle me madhesi mesatare	cope	20
210	spatull silikoni	cope	20
211	spatull alginati	cope	20
212	Tas+spatula set I madh	set	26
213	Tel krosheje 0,7mm	role x20	2
214	Tel krosheje 0,8mm	role x20	102
215	Vida monolaterale (te njeanshme)	cope	30
216	Vida universale (te medha)	cope	80

217	Oksid zink eugenol tubet 300gr +tubet 125gr	kuti x 2 tubeta	100
218	Fill retraktues 000,00,0	flakon	9
219	Flete per skafander mbrojtese	setx10cope	30
220	Llampe alkoli	cope	30
221	Vaj angeli	flakon x 500ml	30

Specifikimet teknike janë hartuar dhe miratuar nga autoriteti kontraktor përfitues **Klinika Stomatologjike Universitare Tiranë**, në përputhje me nenin 36 “*Specifikimet teknike*” të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar si dhe nenin 40 “*Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave*” të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Specifikimet teknike shprehin tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe në përputhje të plotë me funksionet e kërkuara nga Autoriteti Kontraktor përfitues.

Grupi i punes ne hartimin e specifikimeve teknike bazohet në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 1,2 44, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”i ndryshuar, ku citohet:

- 1. Në procedurat e prokurimit për mallra, autoriteti/enti kontraktor parashikon sasinë e mallrave që do të lëvrojë, si dhe grafikun e lëvrimet të mallrave.*
- 2. Për mallrat që do të prokurohen, autoritetet/entet kontraktore parashikojnë specifikimet teknike, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 36, të LPP-së, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara.*

Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Sa me sipër, ky grup në hartimin e nevojave i është referuar kërkesës së departamenteve si dhe specifikimet teknike krahas përshkrimit të saktë të nevojave të mallit, ka marrë në konsideratë fakti se hartimi i specifikimeve teknike duhet bërë në një mënyrë gjithëpërfshirëse duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve duke përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë karakteristikat shërbimeve dhe në përputhshmëri me objektin e kontratës.

Grupi i punes në hartimin e specifikimeve teknike ka në vlerësim se një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit (parashikuar nga neni 2 gërma “c”, “ç”, “d” “dh” e LPP-së) janë ato të transparencës dhe trajtimit të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik. Specifikimet teknike të hartuara ofrojnë akses të barabartë për ofertuesit dhe nuk duhet të kenë efektin e krijimit të pengesave të pajustificuara për hapjen e prokurimit publik ndaj konkurrencës. Në respekt të parimit të mësipërm, specifikimet teknike në asnjë rast nuk duhet të diskriminojnë/përjashtojnë nga konkurimi operatorët ekonomikë ofertues dhe/ose prodhuesit qofshin këto kombëtar apo ndërkombëtar. Në hartimin e specifikimeve teknike AK ka shmangur çdo formë diskriminimi qoftë ato të dukshme qoftë ato të fshehta të cilat kanë të njëjtin efekt. Në asnjë rast specifikimet teknike nuk janë hartuar në mënyrë që të drejtojnë drejt një produkti/mall/shërbim që ofrohen nga një operator i vetëm ekonomik ose nga një prodhues i vetëm.

Në hartimin e specifikimeve teknike grupi i punes mban në vëmendje faktin se specifikimet teknike mbështetur ne nenin 44 te VKM nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, I ndryshuar.

Në vijimësi, Grupi i punes ka zbatuar me përpikmëri dispozitën e mësipërme të LPP-së në hartimin e specifikimeve teknike. Me anë të specifikimeve teknike mundësohet një konkurrim i drejtë i hapur dhe gjithëpërfshirës të barabartë dhe jo diskriminuese për të gjithë operatorët ekonomikë si edhe të mos drejtohen drejt një produkti të vetëm të ofruar nga një operator i vetëm ose nga një numër i kufizuar operatorësh ekonomikë, duke përshkruar minimumin e elementëve teknikë si edhe ka vendosur termin ekuivalent në ato raste kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme, e përshkrimit të kërkesave, me kusht që fjalët “ose ekuivalent” të përfshihen detyrimisht në këto specifikime.

Specifikimet teknike janë hartuar ne perputhje me qëllimin e realizimit të këtij funizimi me qëllim arritjen e efikasitetit dhe efikasitetit, duke garantuar trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si vijon:

1. Materialet stomatologjike duhet te kene daten e skadences jo me pak se 18 muaj nga data e furnizimit te mallit ne magazinën e KSU –se.
2. Te gjithë materialet e mjekimit te kene te percaktuar: emrin e percaktuar nga firma prodhuese (emrin komercial) dhe emrin kimik te produktit, njesine e matjes, firmen prodhuese dhe shtetin. Te jene prodhime CE.
3. Data e skadences (per ato artikuj qe kane date skadence) te jete ne kuti dhe çdo njesi baze .
4. Ne oferte te jete i percaktuar lloji i ambalazhit dhe materialet te kene ambalazhin origjinal nga prodhuesi dhe te mbyllur.
5. Produkti ne brendesi te ambalazhit te koorespondoje me te dhenat e ambalazhit, sipas kërkesave te KSU –se.

6. Te kene bashkengjitur instruksione perdorimi per secilin material.
7. Me sipercifikimet teknike te detajuar per cdo artikull sipas listes bashkelidhur sasise se mallit.

Çdo standard i kërkuar apo çdo referencë marke të mallrave objekt prokurimi, autoriteti kontraktor do të pranojë edhe ekuivalentin e tij.

Transporti e mallrave objekt prokurimi në ambientet e përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor përfitues do të realizohet nga operatori ekonomik fitues.

Për të krijuar dosjen e tenderit në sistemin e prokurimit elektronik të APP dhe për të ngarkuar të gjithë dokumentacionin e procedurës së prokurimit Njësia e Prokurimit autorizoi personin përgjegjës për prokurim.

NJËSIA E PROKURIMIT